

KONFERENCË SHTYPI MË 17 JANAR 2001

I. ZHVILLIMET NË ÇMIMET E KONSUMIT

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë, i përcaktuar në ligjin e bankës qendrore, është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ky objektivi materializohet në synimin për të arritur norma të ulëta të inflacionit vjetor. Për vitin 2000 objektivi u përcaktua në intervalin 2-4 për qind. Përcaktimi i objektivit të inflacionit me anë të një intervali krijon më tepër fleksibilitet për autoritetet në përpjekjet për arritjen e tij, sidomos në ekonomi të pastabilizuara.

Ecuria e inflacionit gjatë viteve 1998 dhe 1999 si dhe për periudhën janar - nëntor 2000 krijoi bindjen që edhe për vitin 2000 do të respektohej objektivi i përcaktuar për inflacionin.

Në fakt nuk ndodhi kështu. Jashtë çdo parashikimi zhvillimet e muajit dhjetor prodhuan një normë mujore inflacioni në masën 4,6 për qind duke sjellë një përmbysje totale të normës së inflacionit nga -0,4 për qind si njëmbëdhjetëmujor (nëntori 2000 kundrejt dhjetorit 1999) në 4,2 për qind në fund të vitit 2000. Ky nivel është rreth 0,2 pikë për qindjeje mbi kufirin e sipërm të objektivit për inflacionin vjetor. Zhvillimi i papritur në çmimet e konsumit vlerësohet të jetë pasojë, kryesisht e dy faktorëve: intensitetit të spekulimit në muajin dhjetor dhe krizës energjitike që përfshiu vendin në tre muajt e fundit të vitit.

Duke parë nga afër zhvillimet e muajit dhjetor, mund të thuhet se spekulimi me çmimet për shkak të festave të fundvitit po bëhet gjithnjë e më shumë përcaktues i normës së inflacionit. Me kalimin e viteve ky "spekulim" sa vjen e rritet.

Megjithëse një pjesë e kësaj rritjeje të lartë ka si pasojë rritjen e kërkesës për mallra konsumi për shkak të festave, vlerësohet se motivi spekulues është i fortë dhe përbën shkakun kryesor të rritjes së pazakontë të çmimeve.



Megjithatë, duhet pranuar se ambienti i vitit që sapo mbyllëm ishte shumë më favorizues për shtimin e spekulimit në ekonomi krahasuar me dy vitet paraardhëse nisur nga përkeqësimi i krizës energjitike në muajin dhjetor. Aq e fortë është dëshira për spekulim sa edhe në rastin e heqjes së detyrimeve fiskale për gazin e lëngët, çmimet mbetën në të njëjtat kuota e për të mos thënë me një rritje të lehtë. Edhe pse çmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare ka rënë, përsëri çmimi i saj në tregun shqiptar ka mbetur i mbërthyer në kuotat e pikut të krizës.

Në fakt, fenomene të tilla si ato që mund të quhen ndikim i sezonit, rritje spekulative të çmimeve, rritje të sforcuara të çmimeve të imponuara nga faktorë *shock* (të brendshëm dhe të huaj) etj., njihen dhe merren parasysh nga bankat qendrore të cilat nga ana e tyre, mundohen të ndërtojnë një tregues të tillë që të arrijë “ta zhveshë” normën e inflacionit nga ndikime të tjera qofshin dhe rastësore, por që nuk janë pasojë e politikës monetare të zbatuar. Treguesi që del nga zhveshja e inflacionit nga këta faktorë “të jashtëm” njihet zakonisht si inflacion bazë ose inflacion qendror.

Përlllogaritjet e Bankës së Shqipërisë për inflacionin bazë konsistojnë në eliminimin e zërave më të paqëndrueshëm të shportës, artikuj të veçantë ushqimorë apo krejt grupin ushqimor si dhe të ashtuquajturit artikuj ushqimorë me karakter sezonal. Nga ana tjetër, në bazë të supozimeve për një ndryshim të sjelljes së konsumit në Shqipëri është përlllogaritur një mënyrë e re matjeje e inflacionit ku pesha e grupit “ushqim, pije dhe duhan” bie në 50 për qind nga rreth 73 për qind që është aktualisht.

Normalisht, duke u ndalur në matjet e ndryshme të bëra (shih grafikun) rezulton se në të gjitha rastet inflacioni aktual në fund të muajit dhjetor 2000, është më i lartë se të gjitha matjet e tjera.

Siç e vëmë re, inflacioni bazë është shumë poshtë atij të faktuar. Ndërsa, nga krahasimi i inflacionit aktual me atë të korrektuar, duke ulur peshën e ushqimeve në 50 për qind të totalit, vërehet se gjatë gjithë vitit kjo matje ka rezultuar mbi inflacionin aktual. Përrjashtim bën muaji i fundit kur përqindja e inflacionit të korrektuar ka zbritur poshtë atij aktual (shih tabelën 1).

Në praktikë, të gjitha ato vende, që kanë si objektiv të drejtpërdrejtë të politikës monetare stabilitetin e çmimeve prej kohësh kanë ndërtuar treguesin që quhet inflacioni bazë. Ajo ç’ka ndryshon nga një bankë në

tjetrën janë supozimet dhe përjashtimet e bëra si dhe metodologjitë e përdorura, të cilat janë në varësi të specifikave të çdo vendi. I njëjtë është fakti që sukcesi i politikës së një banke qendrore matet duke gjykuar mbi ecurinë e këtij treguesi. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë mendon të zyrtarizojë këtë konceptim të ri mbi inflacionin duke sqaruar njëkohësisht dhe opinionin. Nuk mund të lejohet kompromentimi i efikasitetit të politikës monetare nga fakti që, në 15 ditët e fundit të vitit, spekulimi me çmimet e frutave dhe të perimeve (të cilat u rritën 23 për qind në bazë mujore) të çojë në rritje të forta të çmimeve të konsumit në përgjithësi.

Për të konkretizuar këtë fakt mjafton të theksohet se norma mujore e inflacionit bazë, për muajin dhjetor ka rezultuar 0.4 për qind ndërsa në nivel vjetor kjo normë është negative për 0.9 për qind. Kjo do të thotë që inflacioni nuk është prodhuar nga veprimet e politikës monetare, por nën presionin e efekteve sezonale, të rritjes së intensitetit të spekulimit dhe të klimës së pasigurisë të krijuar nga kriza energjitike.

II. ZHVILLIMET NË DEPOZITA, NË TREGUN MONETAR DHE NË KREDI

II.1. Ecuria e depozitave.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2000, depozitat gjithsej në sistem janë rritur 13.3 miliardë lekë, kundrejt 40.3 miliardë lekëve për vitin 1999. Peshën kryesore në këtë rritje e dhanë depozitat në valutë, niveli i të cilave deri në nëntor është rritur 9.9 miliardë lekë, nga 12.9 miliardë lekë në vitin 1999. Ndërkohë depozitat në lekë, janë rritur vetëm 3.4 miliardë lekë, nga 21.1 miliardë lekë në vitin 1999.

Depozitat e kursimit si sistem janë rritur 11.1 miliardë lekë. Nga këto, 8.8 miliardë lekë janë depozita me afat në valutë dhe 2.3 miliardë lekë janë depozita me afat në lekë. Periudha janar-nëntor 2000 është karakterizuar nga tendenca e qëndrueshme në rritje e depozitave në valutë.

Sjellja e depozitave në sistem, gjatë periudhës janar-nëntor 2000, reflekton ndikimin e shumë faktorëve. Një pjesë e tyre është e vështirë që të indentifikohen ose t'u matet efekti për faktin se, statistikat për treguesit realë të ekonomisë mungojnë ose janë shumë të varfra.

Preferenca e publikut për të depozituar kursimet në valutë është kushtëzuar nga tendenca në rënie e nivelit të interesit të ofruar për



depozitat me afat në lekë (si efekt i politikës së ndjekur nga Banka e Shqipërisë për normat e interesit); nga tendenca në rritje, ndonëse e lehtë, e përqindjeve të ofruara për depozitat në dollarë amerikan, marka gjermane, euro; nga ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor dhe nga niveli i lartë i *yield*-it të bonove të thesarit me afat gjashtë dhe dymbëdhjetë muaj.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2000, në ecurinë e depozitave në sistem kanë ndikuar edhe faktorë, që qëndrojnë jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë. Kështu, në fillim të vitit 2000, propaganda e bërë në shtyp dhe media për sigurinë e depozitave të kursimit në Bankën e Kursimeve dha efekt psikologjik tek publiku. Një pjesë e individëve tërhoqën depozitat e kursimit nga kjo bankë.

Kontributi i bankave tregtare në rritjen e depozitave në sistem ka njohur ndryshime për periudhën janar-nëntor 2000. Bankat tregtare me kapital privat dhe të përbashkët e kanë rritur pjesën e depozitave gjithsej ndaj totalit të depozitave gjithsej të sistemit bankar. Kështu, pjesa e depozitave gjithsej të bankave tregtare me kapital privat dhe të përbashkët ndaj totalit të depozitave të sistemit ka arritur në 19.1 për qind, në nëntor 2000, nga 13.5 për qind në fund të vitit 1999. E njëjta tendencë ruhet si për pjesën e depozitave në lekë ashtu edhe të depozitave në valutë. Konkretisht, pjesa e depozitave në lekë të bankave tregtare me kapital privat dhe të përbashkët ndaj totalit të depozitave në lekë të sistemit është rritur nga 3.7 për qind, në fund të vitit 1999, në 8.06 për qind, në nëntor të vitit 2000. Pjesa e depozitave në valutë të këtyre bankave ndaj totalit të depozitave në valutë të sistemit ka arritur në 44.5 për qind nga 39.6 për qind në fund të vitit 1999.

Shifrat tregojnë se kryesisht nga bankat me kapital privat dhe të përbashkët është bërë një punë e mirë në drejtim të tërheqjes së depozitave dhe sidomos atyre në lekë krahasuar me vitet e mëparshme. Nga ana e individëve bankat tregtare, krahas Bankës së Kursimeve, e cila tradicionalisht është njohur si bankë për vendosjen e depozitave të kursimit të popullatës, janë konsideruar si një nga alternativat e mundshme për të investuar kursimet e tyre. Publiku është joshur nga niveli më i lartë i interesave për depozitat me afat, krahasuar me Bankën e Kursimeve. Në muajt e parë të vitit 2000 niveli i interesave të zbatuar nga bankat tregtare qëndronte mesatarisht gati 2 për qind mbi nivelin e Bankës së Kursimeve. Ky nivel erdhi vazhdimisht duke u ngushtuar, duke arritur mesatarisht nën nivelin 1.5 për qind.

II.2. Zhvillimet në tregun monetar.

Në muajin korrik të vitit të kaluar filloi organizimi i ankandeve të marrëveshjeve të riblerjeve. Deri në fund të muajit dhjetor janë kryer 22 ankande të tilla, në të cilat janë ofruar gjithsej 77.6 mld lekë. Ankandet janë organizuar sipas tipit ankande me disa çmime. Nisur nga niveli i rezervave të tepërta dhe parashikimet afatshkurtra për likuiditetin në sistemin bankar, ankandet e zhvilluara kanë synuar tërheqjen e likuiditetit nga sistemi, duke patur si objekt ndikimin në normat afatshkurtra të tregut të parasë. Njëkohësisht, nëpërmjet njoftimit të normës maksimale të interesit të ankandit, Banka e Shqipërisë transmeton në treg sinjale të qarta në lidhje me politikën e saj për normat e interesit.

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në treg nëpërmjet ankandeve të marrëveshjeve të riblerjeve i ka shërbyer rritjes së presionit të saj për uljen e interesave në tregun e parasë. Vlen të përmendet fakti, se gjatë vitit 2000, normat e interesit në tregun primar të bonove të thesarit janë ulur ndjeshëm. Kështu, në fund të vitit 2000 këto norma ishin në nivelet 7.83 për qind, 11.34 për qind dhe 12.32 për qind respektivisht për afatet e maturimit tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë mujore, krahasuar me nivelet respektive 14.86 për qind, 15.39 për qind dhe 15.73 për qind të fillimvitit.

Themi që, nëpërmjet pranisë dhe operacioneve të saj në treg Banka e Shqipërisë ka arritur të përçojë sinjale në treg, të kuptohet nga agjentët e tregut, të ndikojë në sjelljen e tyre, duke arritur synimet e saj. Në arritjen e objektivit operacional të Bankës së Shqipërisë, uljen e normave të interesit në tregun e parasë, kanë ndikuar dhe faktorë të tjerë si stabiliteti i treguesve makroekonomikë, përmirësimi i treguesve fiskalë, rritja e bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave në lidhje me administrimin e borxhit të brendshëm, përmirësimi i mbikëqyrjes bankare dhe administrimi i mirë nga bankat e nivelit të dytë i likuiditeteve të tyre.

Kredia lombard dhe ajo e rifinancimit, si kreditë më të shtrenja, që ofrohen nga Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2000 nuk janë përdorur asnjëherë.

Në muajin dhjetor të vitit 2000, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi kuadrin e instrumenteve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Ky kuadër i ri i instrumenteve të Bankës së Shqipërisë përfshin reformimin e instrumenteve ekzistuese dhe njohjen e instrumenteve të reja, në funksion të rritjes së eficiencës dhe fleksibilitetit



në përdorimin e tyre.

Gjithashtu, janë përgatitur projektrregulloret përkatëse, të cilat përcaktojnë kushtet e zbatimit si dhe mënyrën e funksionimit të instrumenteve të Bankës së Shqipërisë. Këto projektrregullore parashikohen të hyjnë në fuqi në tremujorin e parë të vitit 2001. Tre grupet kryesore të instrumenteve të Bankës së Shqipërisë janë:

- * rezerva e detyrueshme;
- * operacionet e tregut të hapur;
 - ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve ku ankandi javor është instrumenti kryesor i Bankës së Shqipërisë, ndërsa ankandet ditore do të përdoren për rregullime të vogla;
 - operacionet e shit-blerjeve me të drejta të plota të letrave me vlerë dhe valutave;
- * lehtësirat e Bankës së Shqipërisë
 - kredia lombard;
 - kredia njëditore;
 - depozita njëditore.

Mbështetja në këto instrumente bëhet me synim që të rritet fleksibiliteti në hartimin dhe në zbatimin e politikës monetare, të ndihmojë në zgjerimin dhe zhvillimin e tregjeve, në rritjen e konkurrencës, të ndikojë në përmirësimin e eficiencës së ndërmjetësimit të sektorit financiar, të përmirësojë efektivitetin e investimeve si dhe të nxisë rritjen e kursimeve duke i kanalizuar ato në sistemin bankar.

III.3. Zhvillimet në kreditim.

Viti 2000 (deri në nëntor'00) në aktivitetin kreditues tregoi rritje, në përgjithësi, në të gjitha bankat. Në muajin nëntor 2000 gjendja e kredive arriti në 26 miliardë lekë. Kreditimi i ekonomisë për periudhën janar - nëntor 2000, në terma relativë, është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar. Ndërkohë që, gjatë vitit 1999, u akordua kredi e re në masën 8 miliardë lekë, vetëm për njëmbëdhjetë muajt e vitit 2000 niveli i akordimit të kredive të reja ka arritur në masën 21,2 miliardë lekë. Megjithatë, duhet pranuar se në terma absolutë kredia për ekonominë vazhdon të jetë akoma e ulët dhe, për më tepër, vazhdon të kreditohet vetëm në valutë. Gjatë periudhës dhjetor 1999 - nëntor 2000, teprica e kredisë për ekonominë është rritur me 6,2 miliardë lekë, nga e cila 5,8 në valutë dhe 0,4 në lekë.

Përsa i përket afateve të lëvrimin, kredia afatshkurtër dhe ajo afatmesme janë rritur respektivisht me 3 dhe 2,7 miliardë lekë, ndërsa kredia afatgjatë me 0,5 miliardë lekë. Duke iu referuar shifrës 21.2 miliardë lekë (kredi e re), që nga fillimi i vitit situata është:

- 17,5 miliardë lekë kredi në valutë;
- 11,2 miliardë lekë janë kredi afatshkurtër.

Deri tani bankat private, kanë preferuar të japin kredi në valutë dhe shumë pak në lekë pasi:

- bankat japin më shumë kredi për tregti dhe ndërtim,
- ritmi i pranimit të depozitave në valutë në sistemin bankar është i lartë,
- reduktohet rreziku nga luhatja e kursit të këmbimit si pasojë e moskrijimit të pozicioneve të hapura në valutë në masë të konsiderueshme.

Tabela 1: Ecuria e treguesve të kreditit (në miliardë lekë).

Treguesit	Tetor '00	Nëntor '00
Teprica gjithsej e kredisë e sistemit bankar ¹	25.8	26
Teprica e kredisë e sistemit bankar për sektorin publik	1.6	1.6
Teprica e kredisë e sistemit bankar për sektorin privat	24.2	24.4
Teprica e kredisë e sistemit bankar në lekë	9.6	9.7
Teprica e kredisë e sistemit bankar në valutë	14.6	14.7
Pesha (në %) e kredisë në valutë	57.0	60
Kredia e re e sistemit bankar	1.8	2.3
Kredia e re në lekë e sistemit bankar	0.4	0.6
Kredia e re në valutë e sistemit bankar	1.3	1.7
Pesha (në %) e kredisë në valutë	75.0	74

Nga të dhënat e raportuara për bizneset, që janë kredituar nëpërmjet sistemit bankar, 26 për qind të kredive e kanë marrë aktivitetet e ndërtimit, rreth 26 për qind tregtia, rreth 16 për qind industria përpunuese, 5 për qind hotelet dhe restorantet, 6 për qind pasuritë e patundshme dhe pjesën tjetër bujqësia, peshkimi, transporti, shërbimet etj..

Ekonomia ka thithur nga sistemi bankar mesatarisht 1,9 miliardë lekë kredi të re çdo muaj, ndërsa portofoli i kredive të bankave është rritur mesatarisht me rreth 0,56 miliardë lekë në muaj. Kreditimi i ekonomisë deri në fund të nëntorit është realizuar 83 për qind e parashikimit sipas programit monetar. Ndonëse nuk do të arrihet parashikimi i bërë në programin monetar për kreditimin në fund të vitit 2000, ai pritët të realizohet në nivel shumë më të kënaqshëm krahasuar me vitin 1999, vit në të cilin realizimi ishte në masën 31 për qind.

¹ Në gjendjen e kredive për fundin e muajit nëntor 2000 është përfshirë kredia e BKT-së prej 1,5 miliardë lekësh.



Box 1. Vrojtimi me specialistë të kreditit të bankave të nivelit të dytë, në dhjetor 2000.

Nisur nga rëndësia që ka procesi i kreditimit për ekonominë e vendit si dhe argumentet e shumta në lidhje me nivelin e kreditimit, Banka e Shqipërisë ndërmori një vërtetim me specialistë të kreditit të bankave të nivelit të dytë për të mësuar opinionin e tyre mbi këtë problem.

Në opinionet e tyre jepet e qartë preferenca për:

- kredi afatshkurtër (në 68 për qind të të intervistuarve). Madje është pohuar që kredia afatgjatë e akorduar nga bankat është në shkallë më të lartë se sa do të donin bankat të ofronin;
- kredi në valutë (në 100 për qind të të intervistuarve). Ndërsa, 71 për qind e të intervistuarve japin faktikisht kredi në dollarë amerikanë dhe 53 për qind në marka gjermane;
- kredi për sektorët e tregtisë, të industrisë dhe të ndërtimit.

Specialistët e kreditit identifikojnë si arsye kryesore për strukturën aktuale të kredidhënies shkallën e rrezikut në këtë veprimtari. Niveli i rrezikut vlerësohet të jetë në kufijtë mesatarë deri të lartë.

Dhënia e kredive afatshkurtra mundëson një ndjekje operative dhe të vazhdueshme, ndërsa dhënia e kredive në valutë lidhet me preferencat e vetë klientëve si dhe me pasjen e pasiveve (depozita e kapital) në valutë.

Specialistët e kreditit shprehen se në tërësi janë realizuar planet e bankave për kreditim:

- në vitin 2000 është ulur pesha e bankave që nuk akordojnë kredi në krahasim me vitin 1999 nga 33 në 26 për qind;
- në vitin 2000 është rritur pesha e bankave që e kanë realizuar dhe tejkaluar planin e kredisë në krahasim me vitin 1999 nga 50 për qind në 69 për qind.
- mosrealizimi i planeve të kreditimit në disa raste, sidomos në rrethe, është arsyetuar me mungesën e energjisë elektrike.

Nga ana tjetër, specialistët e kreditit rendisin dhe problemet (mangësitë) që paraqesin bizneset gjatë procesit të kërkimit të kredive në banka, mangësi, të cilat çojnë në një shkallë të ulët kreditimi. Këto mangësi, sipas shkallës së rëndësisë renditen:

- mungesë e traditës në marrëdhëniet me bankat;
- paraqitje e bilanceve joreale;
- argumentim i pamjaftueshëm i planeve të biznesit;
- mosnjohje e plotë e kërkesave të bankës;
- mosnjohje e legjislacionit;
- mungesë e aftësive administruese tek bizneset.

Specialistët e kreditit janë relativisht optimistë për të ardhmen e procesit kreditues. Ata mendojnë se më shumë kredi do të drejtohen në sektorët e industrisë dhe të ndërtimit duke ulur angazhimin në kreditimin e tregtisë. Megjithatë, jashtë vëmendjes ende mbetet sektori bujqësor dhe ai i transportit.

III. ZHVILLIMET VALUTORE

III.1. Kursi i këmbimit.

Si shenjë e ndërveprimit të zhvillimeve të tregut të brendshëm të këmbimeve valutore me atë ndërkombëtar, gjatë vitit 2000, kursi i këmbimit të lekut, përveç ndryshimeve në kërkesën dhe ofertën e brendshme për valutë, ka reflektuar gjerësisht edhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të këmbimit.

Kundrejt euros, leku është mbiçmuar. Vlera nominale e raportit EUR/LEK u çel në fillim të vitit në nivelin 137.3 (DEM/LEK=70.2) dhe u mbyll në fund të muajit dhjetor në nivelin 131.2 (DEM/LEK=67.1). I shprehur në terma relativë, mbiçmimi i lekut ishte 4.6 për qind. Siç mund të kuptohet, në të njëjtën masë leku është mbiçmuar ndaj të gjithë nënfishave të tjerë të euros.

Kundrejt dhrahmisë greke (GRD), e cila me anëtarësimin e Greqisë në Bashkimin Monetar Europian duke filluar nga data 1 janar 2001 është shndërruar në një nënfish të euros, leku është mbiçmuar në masën 7.1 për qind.

Kundrejt usd, leku u nënçmua. Në fillim të vitit vlera nominale e raportit USD/LEK ishte në nivelin 135.2, ndërsa në fund të muajit dhjetor, ky raport ishte 143.5. Në terma relativë, leku është nënçmuar në këmbimin me usd në masën 6.1 për qind.

Mbiçmimi i lekut ndaj euros dhe nënçmimi i njëkohshëm ndaj usd, ka reflektuar ecurinë e këtyre dy monedhave në tregjet ndërkombëtare të këmbimit gjatë vitit 2000. Deri në fund të muajit dhjetor, vlerësohet që monedha europiane të ketë humbur rreth 10.6 për qind të vlerës së saj në këmbimin me usd.

Lëvizjet në kursin e këmbimit të lekut gjatë vitit 2000, kanë qenë graduale dhe të balancuara. Për të siguruar një gjë të tillë, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në treg, veçanërisht në periudhën korrik - tetor, kur ndikimet sezonale me efekte mbiçmuese në kursin e këmbimit të lekut, janë të pritshme. Gjatë kësaj periudhe, janë blerë nga sistemi bankar, rreth 35.36 milionë dollarë, ose afërsisht 97 për qind e të gjithë sasisë së blerë gjatë vitit 2000 prej 36.48 milionë dollarësh. Për vitin 2001, presim që kursi i këmbimit të lekut të vazhdojë të jetë i qëndrueshëm, me lëvizje të balancuara, që do të përthithen lehtë nga ekonomia. Banka e Shqipërisë do të jetë e gatshme që të sigurojë këtë ecuri.



III.2. Rezerva valutore.

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2000, vlera e rezervës valutore bruto ka arritur në 607.8 milionë dollarë, ndërsa vlera e rezervës valutore neto në 455.2 milionë dollarë. Që nga fillimi i vitit 2000, rritja e vlerës së rezervës valutore bruto kap shifrën 126.24 milionë dollarë ose 26.2 për qind.

Hyrjet në këtë periudhë kapin shumën 301.3 milionë dollarë, ku veçojmë: në formën e granteve (KE dhe të tjerë) 57.3 milionë dollarë, në formën e huave (FMN, IDA, KE dhe të tjerë) 91.4 milionë dollarë, në formën e blerjeve (nga bankat, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të tjerë) 113.3 milionë dollarë, në formën e të ardhurave nga investimi 24.9 milionë dollarë etj..

Daljet në këtë periudhë kapin shifrën 159.6 milionë dollarë, ku veçojmë: në formën e pagesave të shërbimit të borxhit të jashtëm (të Bankës së Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë) 20.2 milionë dollarë, në formën e transferimeve (Qeveria e Republikës së Shqipërisë, bankat dhe të tjerë) 123.4 milionë dollarë, në formën e shitjeve (për bankat dhe për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë) 15.8 milionë dollarë etj..

IV. ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Në fund të muajit tetor të vitit 2000 aktiviteti i sistemit bankar është rritur me 2.4 për qind kundrejt vitit 1999. Ky tregues për grupin e bankave private është 57.3 për qind, ndërsa për bankat e përbashkëta është 17.6 për qind². Gjithmonë e më shumë po theksohet tendenca për reduktim të peshës së bankave shtetërore dhe nxitje të konkurrencës. Sistemi bankar shqiptar ka vazhduar të operojë me fitim. Ky tregues, nga 2.7 miliardë lekë, që ka rezultuar në fund të muajit shtator 2000 është rritur në 2.9 dhe 3.5 miliardë lekë përkatësisht për muajt tetor dhe nëntor 2000. Rritja, nga muaji në muaj, e fitimit ka përmirësuar edhe nivelin e treguesve të kthyeshmërisë nga aktivet dhe nga kapitali i vet.

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2000, treguan se bankat po rrisin cilësinë e administrimit dhe kanë gjendje të kënaqshme financiare. Janë fuqizuar elementet bazë të të ardhurave si marzhi neto i interesave, cilësia e aktiveve dhe efikasiteti. Nga ana e Bankës së Shqipërisë janë kryer 11 inspektime të plota të bankave dhe 2 të pjesshme, duke bërë të mundur që të realizohet brenda vitit 2000 objektivi i Bankës së Shqipërisë për të

² Në fund të muajit shtator 2000 këta tregues ishin përkatësisht 45.6 dhe 6.5 për qind.

inspektuar çdo bankë një herë në vit gjatë vitit 2001. Për më tepër, këshillat drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë të bankave, kanë reaguar pozitivisht ndaj detyrave dhe rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë lidhur me:

- përmirësimet e duhura në politikat dhe procedurat e huadhënies, e veprimtarisë valutore, e administrimit të rrezikut etj.;
- rritjen e pavarësisë së kontrollit të brendshëm të bankave;
- përmirësimin e procesit të administrimit të aktiveve dhe pasiveve;
- zbatimin e manualit të kontabilitetit bankar;
- zhvillimet strategjike të bankave;
- sigurimin e akteve të brendshme të nevojshme për veprimtari të reja etj..

Banka e Shqipërisë ka vendosur, në disa raste, kontakte të drejtpërdrejta me këshillat drejtues të bankave, me qëllim rritjen e përgjegjësisë së drejtimit ekzekutiv për zbatimin e kuadrit ligjor.

Pavarësisht nga të dhënat pozitive, Banka e Shqipërisë me programin e inspektimeve, që ka hartuar për vitin 2001 do të sigurohet mbi qëndrueshmërinë që kanë të ardhurat e bankave. Kjo do të thotë që do të analizohet nëse këto të ardhura janë rezultat i një përmirësimi në drejtimin e bankës apo rezultat i mjedisit të favorshëm makroekonomik dhe sidomos klimës së përgjithshme të uljes së interesave. Megjithatë, fitimet e realizuara premtojnë për më shumë kredi në vitin 2001.

IV.1. Privatizimi i Bankës së Kursimeve.

Banka e Shqipërisë i ka kushtuar shumë vëmendje privatizimit të Bankës së Kursimeve. Kjo bankë ka një pozicion dominues në sistemin bankar shqiptar dhe është e nevojshme të jemi shumë të kujdesshëm në hapat që ndërmarrim për të mos çenuar stabilitetin e sistemit bankar. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë këmbënguli në kërkesën e saj për rikapitalizimin e Bankës së Kursimeve brenda vitit 2000. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.37, datë 28.12.2000 përcaktoi termat dhe kushtet e bonove të thesarit për detyrimet e shtetit dhe rikapitalizimin e Bankës së Kursimeve sh.a për shumën 17.2 miliardë lekë. Pra, kapitalizimi i kësaj banke u krye nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Këto bono janë emetuar me afat maturimi gjashtëmuor me të drejtë rinovimi. Interesi, që do të paguhet për këto bono është i barabartë me nivelin mesatar të *yield*-it të



bonove të thesarit me të njëjtin afat maturimi të rezultuar në ankandet para dhe pas datës 29 dhjetor 2000. Shuma e emetuar mbulon detyrimin e vjetër të shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve për 7.6 miliardë lekë dhe humbjen e akumuluar nga banka, për 9.6 miliardë lekë.

Duhet theksuar që këto llogaritje janë bazuar në rezultatet e vërtetuara nga kontrollori i jashtëm i pavarur i Bankës së Kursimeve, i cili është KPMG, për bilancet e viteve 1998 dhe 1999. Kjo shumë është e mjaftueshme për të mbuluar vlerën negative të kapitalit rregullator si dhe për të arritur nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit, pra për të respektuar normën prej 12 për qind. Megjithatë, shuma e kapitalizimit nuk arrin të përmbushë detyrimin për kapitalin minimal të paguar prej 700 milionë lekësh. Sipas llogaritjeve paraprake, pasi llogaritjet përfundimtare do të bëhen me përcaktimin e rezultateve në fund të vitit 2000, Ministria e Financave duhet të realizojë detyrimin për plotësimin e kapitalit të nënshkruar në shumën prej 269 milionë lekësh.

Megjithatë, duhet të jetë e qartë që rikapitalizimi i Bankës së Kursimeve nuk është gjithçka për të siguruar suksesin në privatizim. Kujdesi për procesin e privatizimit duhet të jetë i vazhdueshëm dhe tepër i madh. E theksoj, pozicioni dominues i bankës në sistemin bankar kërkon një trajtim tepër serioz. Problemi i privatizimit duhet parë në kompleks. Një ndër objektivat e këtij procesi duhet të jetë eliminimi i deformimeve aktuale në tregun bankar shqiptar. Nëse privatizimi realizon vetëm ndryshimin e pronësisë dhe kalohet nga pozitat dominuese të shtetit në pozitat dominuese të subjekteve private, mund të themi se nuk do të kemi zhvillimet që priten në sistemin bankar.

V. MARRËDHËNIET E BANKËS SË SHQIPËRISË ME GAZETARËT

Në datën 15 dhjetor 2000, siç jeni në dijeni, Banka e Shqipërisë organizoi një seminar kualifikimi me gazetarët ekonomikë të medias së shkruar në vend. Ky ishte fillimi i mbajtjes së premtimit tim për të përfshirë në procesin e edukimit të publikut gazetarët. Kjo besoj do të ketë përfitim të dyanshëm. Me këtë rast, kërkoj edhe një herë mbështetjen dhe mirëkuptimin tuaj për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë si dhe trajtimin e problemeve të ekonomisë dhe të politikës së bankës qendrore duke u larguar nga ndonjë element spekulues. Seminari i organizuar vjet, e theksoj, ishte një fillim që nuk do të ndërpritet aty. Për vitin 2001 Banka e Shqipërisë ka hartuar një program për organizimin e seminareve me gazetarët.